

UDHËZIM
Nr. 509, datë 27.8.2019

**PËR PROCEDURËN E KORRIGJIMIT TË EMRIT, MBIEMRIT, EMRIT TË
BABAIT, EMRIT TË NËNËS, SI GABIM MATERIAL**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 36, 57/7, 57/8, 57/9 dhe të gurmës “a”, të nenit 65, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

1. Shtetasi shqiptar që pretendon se në përbërësit e gjendjes civile, emër/mbiemër, emër i babait/emër i nënës, ka gabime materiale, të cilat mund të jenë shkaktuar gjatë transkriptimit të akteve të gjendjes civile, si pasojë e regjistrimit, ndryshimit apo transferimit të vendbanimit, paraqet kërkesë për korrigjimin e tyre, pranë zyrës së gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative ku rezulton i regjistruar.

2. Përveç korrigjimeve të parashikuara në pikën 1, të këtij udhëzimi, shtetasi mund të kërkojë përmirësimin e përbërësve të gjendjes civile, rubrikës së emrit, mbiemrit për saktësimin e shkronjave të veçanta, që lidhen me rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

3. Kërkesa e shtetasit, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij udhëzimi administrohet nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative, i cili kryen verifikimet e nevojshme administrative dhe mbledh dokumentacionin përkatës, sipas akteve të gjendjes civile, të dhënave të dokumentuara, regjistrimeve në rend kronologjik duke iu referuar regjistrimit fillestar.

4. Mbledhja e dokumentacionit ndërmjet zyrave të gjendjes civile në bashki/njësi administrative dhe zyrave të arkivës së gjendjes civile, kryhet në formë shkresore dhe elektronike për aktet që administrojnë, dokumente të nevojshëm për verifikimin e të dhënave në lidhje me objektin e kërkesës për korrigjim.

5. Për rastet e parashikuara në pikën 2, të këtij udhëzimi, kërkesa mund të shoqërohet me çdo dokument tjetër, që vihet në dispozicion nga kërkuesi, në të cilin provohet shqiptimi ndryshe nga shkrimi i gërmave të veçanta.

6. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në bashki/njësi administrative, në përfundim të procedurës së verifikimit dhe mbledhjes së dokumentacionit të nevojshëm sipas pikës 4, të këtij udhëzimi, harton relacionin ku shpreh mendimin e tij mbi objektin e kërkesës dhe së bashku me dokumentacionin shoqërues, e dërgon brenda 3 (tri) ditëve pune në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.

7. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile shqyrton kërkesën, relacionin e nëpunësit të gjendjes civile dhe dokumentacionin shoqërues, nëpërmjet personave përgjegjës të ngarkuar dhe brenda 7 (shtatë) ditëve pune, shprehet me vendim të arsyetuar, për pranimin apo refuzimin e kërkesës.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile kryen verifikime të mëtejshme, në të dhënat e administruara nga shërbimi i gjendjes civile dhe në akte të organeve të tjera shtetërore, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe të bazuar, për korrigjimin e përbërësve të gjendjes civile si gabim i provuar material.

9. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në bashki/njësi administrative, kryen veprimet në rubrikën përkatëse në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 (në vijim referuar RKGJC), për korrigjimin e përbërësve të gjendjes civile, sipas vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile.

10. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në bashki/njësi administrative, kryen veprime për korrigjimin si gabim material të rasteve të thjeshtuara, të cilat i referohen gabimeve të ndodhura

gjatë transkriptimit të të dhënave, nga operatorët për krijimin e bazës elektronike të të dhënave të RKGJC-së. Rastet e thjeshtuara përfshijnë korrigjimin drejtpërdrejt të të dhënave të RKGJC, siç janë transkriptuar në regjistrin themeltar të regjistrimit të popullsisë të vitit 1974 në rubrikën e:

- a) emrit;
- b) mbiemrit;
- c) emrit të babait; dhe
- d) emrit të nënës.

10.1 Për korrigjimin e rasteve të thjeshtuara nuk ndiqet procedura e përcaktuar në pikat 1 deri 9 të këtij udhëzimi. Korrigjimi i këtyre gabimeve kryhet me kërkesë të shtetasit ose nëse gabimi konstatohet nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, shtetasi njoftohet për gabimin e konstatuar dhe për paraqitjen e kërkesës. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile mban procesverbal dhe pasqyron korrigjimin në RKGJC, me shënimin *“Korrigjohet e dhëna sipas përmbajtjes së Regjistrit Themeltar dhe pikës 10, të këtij udhëzimi”*.

11. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në bashki/njësi administrative, kryen veprime për korrigjimin dhe plotësimin e mbiemrit para martese, si përbërës të gjendjes civile, kur kjo e dhënë është plotësuar gabim ose nuk rezulton e pasqyruar në RKGJC. Korrigjimi i këtyre gabimeve kryhet me kërkesë të shtetasit ose nëse gabimi konstatohet nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, shtetasi njoftohet për gabimin e konstatuar dhe për paraqitjen e kërkesës. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile kryen verifikimet e nevojshme sipas pikës 4 të këtij udhëzimi, mban procesverbal dhe pasqyron korrigjimin/plotësimin në RKGJC, me shënimin *“Korrigjohet/plotësohet e dhëna sipas pikës 11, të këtij udhëzimi”*.

11.1 Korrigjimi i mbiemrit para martese, përfshin pasqyrimin e këtij përbërësi siç rezulton i transkriptuar në regjistrin themeltar të regjistrimit të popullsisë, të vitit 1974.

11.2 Plotësimi i mbiemrit para martese, përfshin rastin e pasqyrimin të këtij përbërësi kur nuk është i plotësuar në regjistrin themeltar të regjistrimit të popullsisë të vitit 1974, duke iu referuar regjistrimeve të mëparshme në rend kronologjik të shtetasit.

12. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, kryen veprimet për zbatimin e vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile në rubrikën përkatëse të RKGJC-së, duke cilësuar përshkrimin sipas të dhënave referuese për numrin dhe datën e vendimit.

13. Rastet e korrigjimit të bëra sipas pikave 10 dhe 11, të këtij udhëzimi, i nënshtrohen kontrollit administrativ nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

14. Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile hartohet në tre kopje, nga të cilat një kopje i dërgohet zyrës së gjendjes civile që ka dërguar kërkesën, një kopje prefektit të qarkut dhe një kopje mbahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

15. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile njofton shtetasin, për vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, brenda 2 (dy) ditëve pune nga komunikimi i vendimit.

16. Me zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki/njësi administrative.

17. Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 481, datë 5.9.2013 “Për procedurat e korrigjimit të emrit/mbiemrit si gabim material”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj